




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRI



URDHËR

Nr. 44, datë 11.4.2017

PËR

**EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË AGJENCISË SË  
SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 6, të nenit 14, të ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, dhe pikës 7, të vendimit nr.109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit

URDHËROJ:

1. Znj. Dhurata Bozo të emërohet drejtor i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.
2. Marrëdhëniet e punës t’i fillojnë nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

NR.PROT.1974/1  
DATË 14. 2017

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT  
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË  
ARSIMIN E LARTË

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjell AGAÇI**

